



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 671 Prot
8

Tiranë, më 24.5.2022

VENDIM

Nr. 16, datë 24.5.2022

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 671 Prot., datë 29.03.2022, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuesit, nëpërmjet kërkesës datë 08.03.2022, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, si më poshtë:

1. Sa tendera janë zhvilluar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për periudhën 01.01.2019 - 28.02.2022?
2. Një listë me numrat e referencës së këtyre procedurave të zhvilluara.
3. Sa tendera të natyrës së mbyllur/sekrete ka zhvilluar Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për shkak të situatës së jashtëzakonshme për periudhën e sipërpërmendur?
4. Një listë me numrat e referencës së këtyre procedurave të zhvilluara.
5. Cila ka qenë arsyeja që Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka zhvilluar këto procedura në formë të mbyllur sekrete? Kërkoj një shpjegim për secilin tender të zhvilluar.

6. *Sa ka qenë fatura totale për tenderat e zhvilluar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për periudhën 01.01.2019 –28.02.2022?*
7. *Sa ka qenë fatura totale për tenderat e mbyllur/sekretë të zhvilluar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për periudhën 01.01.2019 –28.02.2022?*

Në mungesë të një përgjigje nga ana e Autoritetit Publik, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankim pranë Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Zyra e Komisionerit, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit” dhe ankuesi legjitimohet në kërkimin e tij.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”*, Komisioneri, me shkresën nr. 671/1 prot., datë 31.03.2022 ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion, brenda datës 07.04.2022.

Ankuesi, në mungesë të një përgjigje nga Autoriteti Publik, ka vijuar ankimin me emailin e regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 671/2 Prot., datë 19.04.2022.

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 1544/3 Prot., datë 26.04.2022, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 671/3 Prot., datë 28.04.2022, ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: *“Informacioni i kërkuar lidhet me procedurat e prokurimit publik, i cili përfshihet në kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe aksesohet nga të interesuarit pranë faqes zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik www.app.gov.al, konkretisht në rubrikat: Buletini i Njoftimeve Publike, Njoftimi i kontratës së shpallur, Njoftimi i fituesit, Njoftimi i lidhjes së Kontratës si dhe rubrika të tjera sipas kategorisë së informacionit për të cilin kërkoni. Për sa më sipër, po i përcjellim Agjencisë së Prokurimit Publik për kompetencë dhe trajtim kërkesën tuaj lidhur me këto procedura.*

Për 14 procedurat e blerjeve të zhvilluara bazuar në VKM Nr.203, datë 26.02.2020 “Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit” të ndryshuar, referojmë 416,617,248 lekë me TVSH. Në lidhje me pagesat e kryera nga MSHMS për kontratat e Aparatit, pavarësisht se çdo pagesë gjendet lehtësisht në faqen zyrtare të MFE www.financa.gov.al”, sërish kërkesa i përcillet për kompetencë dhe trajtim Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit.”

Gjithashtu, me shkresën nr. 1544/2 Prot., datë 26.04.2022, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 671/3 Prot., datë 28.04.2022, Autoriteti Publik ka përcjellë për kompetencë dhe trajtim kërkesën për informacion pranë Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit.

Në vijim, me shkresën nr. 2910/1 Prot., datë 29.04.2022, Agjencia e Prokurimit Publik ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: *“Në bazë të parashikimeve të nenit 21 të Ligjit për Prokurimin Publik, autoriteti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Për sa më sipër, dokumentacioni i plotë i procedurës së prokurimit, administrohet nga vetë autoriteti kontraktor, që ka zhvilluar procedurën e prokurimit.”*

Pas përgjigjes së sipërcituar, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në të cilin parashikohet se: *“...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”,* bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri vlerësoi zhvillimin e një seance dëgjimore. Seanca dëgjimore u zhvillua me praninë e ankuesit, i cili konfirmoi marrjen e informacionit vetëm për pikën 3 dhe 7 të kërkesës për informacion dhe në mungesë të Autoritetit Publik.

Me emailin e regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 671/7 Prot., datë 18.05.2022, ankuesi, pas zhvillimit të seancës dëgjimore ka vijuar ankimin duke kërkuar dhënien e informacionit nga Autoriteti Publik, lidhur me pikat 1, 2, 4, 5 dhe 6 të kërkesës për informacion datë 08.03.2022.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës, parashtrimeve të paraqitura nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI.

Nga shqyrtimi i çështjes konstatohet se objekti i kërkesave ka të bëjë me kontrata të punëve publike, të cilat i nënshtrohen gjithashtu dispozitave të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar (ligji i zbatueshëm në atë periudhë), si dhe ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Në lidhje me argumentin e parashtruar nga Autoriteti Publik, sipas të cilit: *“Duke qenë se informacioni i kërkuar lidhet me procedurat e prokurimit publik, mund aksesohet pranë faqes zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik www.app.gov.al, si dhe sa i përket pagesave të kryera nga Autoriteti Publik, çdo pagesë gjendet në faqen zyrtare të MFE www.financa.gov.al”,* Komisioneri vlerëson se ky pretendim nuk qëndron. Në përgjigjen e dhënë, konstatohet se Autoriteti Publik ka referuar faqet zyrtare të institucioneve, ku pretendon se është publikuar informacioni dhe jo adresën e saktë të tyre, në mënyrë të tillë që informacioni të gjendet lehtësisht nga kërkuesi.

Ky qëndrim i Autoritetit Publik vjen në kundërshtim me parashikimet e pikës 2 të nenit 16 të LDI, në të cilën parashikohet se: *“Kur informacioni kërkohet në format elektronik dhe ai gjendet në internet, autoriteti publik i tregon menjëherë kërkuesit adresën e saktë të faqes se ku mund të gjendet informacioni...”*. Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson se, Autoriteti Publik për vendosjen në dispozicion të informacionit të kërkuar, duhet t'i

tregojë ankuesit adresën e saktë në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, në të cilën gjendet informacioni i kërkuar.

Për sa i përket pretendimit të Autoriteti Publik se ka deleguar për kompetencë dhe trajtim kërkesën për informacion pranë Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, Komisioneri vlerëson se, ky pretendim nuk qëndron, pasi në përputhje me pikën 2 të nenit 12 të LDI, arsyeja e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës një autoriteti tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar.

Ndërkohë, në kushtet kur ka një përgjigje nga Agjencia e Prokurimit Publik, e cila citon se: *“Në bazë të parashikimeve të nenit 21 të Ligjit për Prokurimin Publik, autoriteti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Për sa më sipër, dokumentacioni i plotë i procedurës së prokurimit, administrohet nga vetë autoriteti kontraktor, që ka zhvilluar procedurën e prokurimit”*, Komisioneri vlerëson se Autoriteti Publik e ka deleguar kërkesën në kundërshtim me përcaktimin ligjor, duke refuzuar në këtë mënyrë kërkesën për informim.

Bazuar në nenin 1 të LDI, objekt i këtij ligji është çdo informacion që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. Në këtë kuptim, çdo autoritet pavarësisht nëse është në cilësinë e *“prodhuesit”* apo *“mbajtësit”* të informacionit, detyrohet në kuptim të këtij ligji të garantojë njohjen e publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë.

Gjithashtu, pika 1 dhe 2 e nenit 21 të Ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, përcakton se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi. 2. Autoriteti ose enti kontraktor administron të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi deri te zbatimi i kontratës, me qëllim kontrollin e zbatimit të ligjit”*.

Për sa më sipër, fryma e përgjithshme e legjislacionit për prokurimit publik është të sigurojë integritet, besim në publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik, nga ana e Autoriteteve Publike, duke bërë publik sa më tepër informacion që lidhet me këto procedura dhe jo duke e kufizuar atë.

Në lidhje me dokumentacionin e kërkuar, theksojmë se, bazuar në gjurmën e, pika 1, të nenit 7 të LDI dhe Urdhrit nr.187 datë 18.12.2020 *“Për miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar”* i ndryshuar, të Komisionerit, një pjesë e informacionit të kërkuar përfshihet në kategorinë e informacionit, që vendoset në dispozicion të publikut pa kërkesë.

Konkretisht, dispozita e sipërcituar përcakton se: *“Në përputhje me programin e transparencës së miratur për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre të internetit.... ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/ partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik privat, duke përfshirë:*

- i. listën e kontratave të lidhura;*
- ii. shumën e kontraktuar;*
- iii. palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara;*
- iv. informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme.*

Për sa më sipër, Autoriteti Publik në përputhje me dispozitën e sipërcituar duhet të kishte trajtuar kërkesën për informacion, në kushtet kur një pjesë e informacionit të kërkuar rezulton se duhet të jetë publik në mënyrë proaktive në programin e tij institucional të transparencës.

Në këto rrethana, Komisioneri vlerëson se, informacioni/dokumentacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të LDI, sipas të cilës: *“Informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”.*

Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar duke mbajtur në konsideratë parashikimin sipas pikës 6 të nenit 17 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ku përcaktohet se: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”.*

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike. Në këtë kontekst, në lidhje me të njëjtën objekt kërkesë për informacion, Zyra e Komisionerit ka krijuar një praktikë të konsoliduar përmes vendimmarrjeve për raste të ngjashme, të cilat janë të publikuara në faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3, të nenit 3 të LDI, *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.*

Bazuar në nenin 15 të po këtij ligji, “autoriteti publik trajton kërkesën për informim brenda 10 ditëve pune nga data e dorëzimit të saj”. Ndërkohë në pikën 1, të nenit 18 parashikohet se mosrespektimi i dispozitave të këtij ligji, passjell përgjegjësi administrative. Në pikën 2, të nenit 18 parashikohet se veprimet dhe mosveprimet, në përputhje me këtë ligj dhe për aq sa nuk përbëjnë vepër penale konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë personat përgjegjës.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funkcionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të Ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 671 Prot., datë 29.03.2022, të z. _____, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 08.03.2022, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, konkretisht: (“1. Sa tendera janë zhvilluar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për periudhën 01.01.2019 - 28.02.2022? 2. Një listë me numrat e referencës së këtyre procedurave të zhvilluara. 4. Një listë me numrat e referencës së këtyre procedurave të zhvilluara. 5. Cila ka qenë arsyeja që Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka zhvilluar këto procedura në formë të mbyllur sekrete? Kërkoj një shpjegim për secilin tender të zhvilluar. 6. Sa ka qenë fatura totale për tenderat e zhvilluar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për periudhën 01.01.2019 – 28.02.2022?”), brenda datës 01. 6.2022.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 26 . 5 .2022.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

